

E ENJTE DATA 23 SHKURT 2023

FJALA E DEPUTETIT PETRIT VASILI

Zonja Kryetare!

Së pari, ju kërkoj të monitoroni veprimtarinë e sekretarisë suaj, pasi monitorët i lëvizin sekondat siç duan vetë, herë para e herë mbrapa, dhe kjo kohë është e pamatshme. Së dyti, duhet të ndahet një herë e përgjithmonë që kjo është salla e deputetëve dhe jo salla e Gardës. Garda e di ku e ka vendin. Sa për kujtesë të këtyre që janë më të rinj, kur ka qenë e nevojshme, po në këtë sallë, deputetë të nderuar të Partisë Socialiste kanë shkuar për të komunikuar deri aty ku jeni ju (kujtoj këtu zonjën Dade e të tjerë), por nuk ka ndodhur asnjë dramë, pasi kjo ka qenë pjesë e komunikimit. Salla e Kuvendit nuk mund të kthehet në kazermë të Gardës. Së treti, Kryeministri i Shqipërisë varet nga Kuvendi, zonja Kryetare! Nuk është Kuvendi peng i agjendave të Kryeministrit. Kryeministri jep llogari në Kuvend, votëbesohet në Kuvend, shkarkohet në Kuvend, ndaj s'mund të jetë as peng i qejfeve, as i ahengjeve, as i bredhjeve lart e poshtë të Kryeministrit, që nuk mbarojnë ndonjëherë. Të gjithë kryeministrat e përgjegjshëm të globit, ata që kanë një fije fytyrë, lënë çdo lloj agjende tjetër, kur kërkohen nga Kuvendi i tyre. Madje i lënë edhe për ngjarje të tjera të rëndësishme, kurse ai që terezit vetëm ahengjet e tij, është Kryeministri ynë.

Sa i takon funksionimit korrekt të këtij parlamenti, po ju them vetëm një gjë shumë të pabesueshme, por të vërtetë: në datën 1 shkurt, pikërisht dy muaj e ca më pas, Sekretariati juaj i famshëm i Procedurave dhe Rregulloreve më komunikon se sapo është zbardhur masa e dënimit, që më është dhënë mua më 24 nëntor, për përjashtimin nga seanca. Dy muaj! E-mail-i zyrtar s'është imi, por i rrjetit e-parlament. Më thoni pak, çfarë parlamenti është ky, që pas dy muajsh më vë në dispozicion dokumentet përkatës, ndërsa ju bëni be për funksionimin e këtij parlamenti?! Gjithmonë u referohem fakteve. Sepse ju, jo ju personalisht, por e kam fjalën për mentalitetin kolektiv, edhe para fakteve që bëjnë mu, nuk reagoni në mënyrë absolute. Ky është një skandal këtu. Kjo për të kuptuar si funksionon, sepse çdo gjë funksionon në bazë të agjendës që ka mazhoranca për të çuar punët e veta përpara. (Bie gongu) Së katërti, sa i takon ligjit të komisioneve hetimore, po jua them njëherë e përgjithmonë: tërhiquni nga ky turp! Ky është turp shumë i madh, sepse po në këtë parlament, gjë që po e përsëris për të njëzetën herë, ndonëse bëjnë sikur janë të heshturit e dobishëm (nuk do të vë nofka, nofkat do t'jua lë juve), me vendim të Gjykatës Kushtetuese, Kodi Penal duhej të ndryshonte për të mos i arrestuar njerëzit nëpër tubime, por nuk ndryshoi, ndaj njerëzit vazhdojnë të arrestohen. (Bie gongu.) Ndërsa kur vjen puna për ligjin e komisioneve hetimore, ah po, këtu do të presim që të rregullohet ligji, pastaj të bëjmë komisionin hetimor. Ky është një turp i padëgjuar, po njëkohësisht edhe një përgjegjësi shumë e rëndë në lidhje me shkeljen e Kushtetutës dhe të Rregullores. I keni të gjitha mundësitë që ta ktheni normalitetin duke mos bërë asnjë sakrificë, por vetëm duke zbatuar Rregulloren.

E fundit, do të më lejoni edhe pak sekonda, ka ndodhur gjithashtu që në komisionin ku unë bëj pjesë, në Komisionin e Shëndetësisë, që qeveria të vijë e të propozojë ligje së bashku me institucionet e pavarura të këtij Kuvendi, konkretisht me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare. Qeveria dhe institucionet e pavarura janë ballë përballë me njëri-tjetrin, jo në krah të njëri-tjetrit. Kjo ka ndodhur, është publike. E kam ngritur si çështje, kam kërkuar të ndërpritet një gjë e tillë. Ju kërkoj dhe ju tërheq

vëmendjen, që ta keni parasysh edhe ju, sepse kjo anarshi është bërë normë dhe institucionet e pavarura kanë rënë përfundimisht, pra ato që unë i kam quajtur në këtë sallë institucione kukulla. Është provuar se qeveria dhe institucionet e pavarura vijnë bashkë dhe propozojnë ligje. Kjo është e padëgjuar. Pra, ky është Kuvendi, i shpartalluar në procedurë, në formë, në përmbajtje, që sot ju përpigjeni ta mbani në këmbë.